



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKTLIGJ

Nr. _____ / 2017

PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8438, DATË 28.12.1998,
“PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1 dhe 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 11, “Kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme”, pas pikës 3, shtohet pika 4, me këtë përmbajtje:

“4. Ministri përgjegjës për financat dhe ministri apo institucioni që ka në fushën e përgjegjësisë regjistrimin e pasurive të paluajtshme, përcaktojnë me udhëzim të përbashkët kushtet, procedurat dhe metodologjinë për zbatimin e këtij neni.”.

Neni 2

Në nenin 18, “Përrjashtimet”, bëhen këto ndryshime:

1. Pas shkronjës “f”, shtohet shkronja “g”, me këtë përmbajtje:

“g) Strukturat akomoduese “Hotelet me katër dhe pesë yje, status special”, sipas përcaktimeve në legjislacionin e fushës së turizmit. Përrjashtimi nga tatimi mbi fitimin, i parashikuar sipas këtij paragrafi, aplikohet për një periudhë 10-vjeçare për ato struktura të cilat përfitojnë statusin special deri në dhjetor 2024. Efektet e përrjashtimit fillojnë në momentin e fillimit të veprimtarisë ekonomike të strukturës akomoduese, por jo më vonë se 3 vjet nga marrja e statusit special.”.

2. Në paragrafin e fundit, fjalët “...deri në shkronjën “f”,...” zëvendësohen me “... deri në shkronjën “g”,...”.

Neni 3

Neni 28, “Shkalla tatimore”, ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

“Neni 28
Shkalla tatimore

1. Tatimi mbi fitimin është 15 %.
2. Për personat juridikë të cilët ushtrojnë aktivitet për prodhimin/zhvillimin e *software*-ve, tatimi mbi fitimin është 5 %. Këshilli i Ministrave përcakton, me vendim, aktivitetet që përfshihen në fushën e prodhimit/zhvillimit të *software*-ve si dhe procedurat për zbatimin e këtij paragrafi.”.

Neni 4

Ky ligj botohet në “Fletoren zyrtare” dhe hyn në fuqi më 1 janar 2018.

K R Y E T A R I

GRAMOZ RUÇI